



SHIKOJ.COM

Njëzet vjet ngatërresa ballkanike

Përktheu nga origjinali: ZEF MAZI

PARATHËNIE

Historia që po paraqes është e mbushur me ngjarje të vogla, por të mbledhura me kujdes, sepse ngjarjet e vogla tregojnë nga fryjnë erërat. Erërat fryjnë edhe në drejtime të kundërta, e kësisoj mund të ngrenë edhe vorbulla stuhie.

Për këtë arsye, më duket se ia vlen të tregohet historia e kompleteve dhe e kundërkompleteve, të cilat i kam jetuar vetë gjatë shumë vjetëve udhëtimi nëpër Ballkan. Zhvillimet e mëvonshme kanë hedhur dritë mbi ngjarjet, që për atë kohë ishin të pakuptueshme, prandaj edhe unë vetë jam i habitur tani që shoh se faktet e imëta, të cilat i pata shënuar në ditaret e mia, pajtohen pikë për pikë me pohimet zyrtare.

Çdo hollësi, çdo mendim i ri mund t'u vijë në ndihmë historianëve të ardhshëm, sigurisht në kohë më të qeta se tani, që ta kuptojnë drejt katastrofën botërore*. Është pikërisht kjo shpresë që më bën të hedh në letër faktet kryesore të skenave që kam parë me sytë e mi, e ku, disa herë, kam luajtur edhe unë njëfarë roli.

E. DURHAM

* Lufta e Parë Botërore.

KREU I

DUKE KAPUR FILLIN

Gusht i vitit 1900. Isha në Cetinjë, e këtu për herë të parë kapa një fill të lëmshit ballkanik, pa e menduar se sa shumë do të ngatërrohesha më vonë, dhe, ca më keq, pa më shkuar fare nëpër mend sesi ky lëmsh do të plekste më në fund tërë botën. Rasti më hodhi në Lindjen e Afërme. Ndihesha krejt e këputur nga kujdesi e shërbimet e vazhdueshme që i bëja një të afërmit tim të sëmurë, dhe shihja të shtrihej para meje një e ardhme pafundësisht monotone, pa shquar dot ndonjë shpresë shpëtimi prej saj. Mjeku tregohej më zemërmirë nga ç'pandehete, kur ngulte këmbë që çdo vit të bëja dy muaj pushim.

— Ju duhet të shkoni të pushoni në ndonjë vend krejt të panjohur, — më tha. — Madje, nisuni që tani, ku të doni, mjafton që çdo gjë të jetë ndryshe nga këtu.

Së bashku me një miken time hipëm në avulloren e shoqërisë austriake «Llojd», në Trieste, e u nisëm për në skelat e Adriatikut Lindor, me shpresa të mëdha, por me shëndet të rënë.

Tek gjarpëronim me kujdes përmes asaj morie ujdhesash që nxirrnin krye në kaltërsinë magjepsëse të pashoqe të detit, duke ndeshur çdo ditë qytete të lashta, ku fliteshin gjuhë të çuditshme dhe ku veshjet ishin edhe më të çuditshme, nisa ta ndieja se, në fund të fundit, ia vlente ta jetoje jetën. Ndërkohë, bukuria e Lindjes së Afërme më bëri për vete.

Në Cetinjë m'u krijua bindja se e kisha gjetur «vendin krejt të panjohur» që kisha kërkuar. Kështu, pra, rastësia më solli në Ballkan.

Në atë kohë Cetinja ishte vetëm një fshat me çati të kuqe, që shquhej qartë në mes të një fushe të rrethuar me male. Shumica e kasolleve ishin përdhese, e në to banonin rreth tre mijë frymë.

Nga Cetinja shkuam në Podgoricë, ku për herë të parë pa-

shë shqiptarë. Podgorica ishte plot me shqiptarë, të veshur të gjithë me kostume kombëtare, sepse deri në atë kohë Mali i Zi nuk kishte bërë shumë përpjekje për ta ndërtuar një gjë të tillë. Si vizita e parë që qe, u mjaftova deri këtu e nuk shkova më tej.

Por kisha gjetur «vendin ku çdo gjë do të ishte ndryshe»; u njoha gjithashtu me idenë e Serbisë së Madhe, dhe më shpjeguan domethënien e «kësulës malaziase»; njëkohësisht më treguan se qëllimi i vetëm i ekzistencës së Malit të Zi ishte rindërtimi i Perandorisë së Madhe Serbe të mesjetës. Po kështu, mësova se hapi i parë në këtë drejtim duhej të ishte marrja e sanxhakut të Novi-Pazarit, të cilin Fuqitë e Mëdha, në Kongresin e Berlinit, e kishin krijuar si gardh midis dy degëve të racës serbe. Në atë kohë këto ide më tingëllonin fantastike-teatrale. Mirëpo kisha akoma për të mësuar: opera e Ballkanit është shkruar me gjak, dhe kur bie sipari, ata që vdesin nuk kthehen më në jetë.

Kaq për Malin e Zi. Pas një udhëtimi të shkurtër në Trebinjë, në Sarajevë dhe në Mostar, u ktheva përsëri në bregdetin dalmat, e prej aty në Trieste.

Pasi pata kapur fillin e lëmshit ballkanik, mendova se ajo që duhej të bëja paskëta, ishte të mësoja një gjuhë ballkanike, sepse në vitin 1900 ishte zor të gjeje njeri në Mal të Zi, që të fliste ndonjë gjuhë tjetër veç serbishtes, dhe as që mund të gjendej ndonjë fjalor i një gjuhe të huaj në Cetinjë. E vetmja librari në Mal të Zi ishte nën mbikëqyrjen e rreptë të princit,* i cili kujdesej që populli të lexonte gjëra që të mos i çorodisnin mendjen. E vetmja letërsi që mund të të binte në dorë ishin kryesisht baladat e moçme kombëtare dhe veprat poetike të princit dhe të të atit, vojvodës së madh, Mirko.

Ishte pothuaj e pamundur të gjendej një mësues i serbishtes në Londrën e vitit 1900, dhe i vetmi libër në qarkullim ishte një Dhjatë e Re, e botuar nga Shoqëria Ungjillore. Më në fund, u gjet një polak, refugjat politik i ikur nga Rusia, studiues i të gjitha gjuhëve sllave, që mori përsipër të më mësonte

* Princi ose knjazi Nikolla Petroviç Njegosh (1841-1921) ishte princ i Malit të Zi nga viti 1860 deri më 1910 e pastaj u shpall mbret (kraj) Nikolla i Parë deri më 1916. Autorja e quan më tej edhe Nikita. Ka qenë i njohur për politikën shoviniste ndaj Shqipërisë. Vdiq në Itali dhe eshtrat e tij u sollën në Mal të Zi më 1989. Ishte i biri i vojvodës Mirko Petroviç dhe i princeshës Milena. Pati shumë fëmijë, ndërmyet tyre Danilon që ishte edhe trashëgimtari i tij si djali i parë, ndërsa djali i dytë, Mirkoja pretendonte fronin e Serbisë.

serbishten. Kishte qenë disa javë në Angli, por nuk dinte asnjë fjalë anglisht, dinte vetëm pak gjermanisht.

I kërkoja të më tregonte përshtypjet e tij të para. Ajo që e habiste më shumë ishte se anglezët e kujtonin Rusinë për ndonjë fuqi të madhe, madje ia kishin edhe frikën. Unë i shpjegoja se Rusia ishte një përbindësh gjithmonë i gatshëm të hidhej në kufijtë e Indisë që e kishim ne, se ajo kishte pasuri përrallore dhe hordhi të panumërta. Ai qeshi tërë përçmim. Me atë gjermanishten e tij të thyer më tha:

— Rusia është një hiç, një hiç. Pasurinë e ka nën tokë, dhe as që dinë se si ta nxjerrin. Ushtrinë vërtet e ka të madhe, por të krimbur. Gjithë Rusia është e krimbur kokë e këmbë. Po plasi ndonjë luftë, ushtria ruse do të bëhet... do të bëhet... — u belb duke u përpjekur të gjejë fjalën, — ja, kështu do të bëhet! — dhe rrëmbeu një copë letër të keqe, e zhubrosi dhe e flaku tërë mllef në kosh.

Ky gjest më mbeti në mendje. Më vonë, kur dëgjoja që njerëzit parashikonin shkatërrimin e pashmangshëm të Japonisë, në rast se ajo do ta cingëriste përbindëshin, dhe flisnin tërë ngazëllim për «makinën luftarake ruse», më dilte parasysht ai shuku i letrës që fluturonte në kosh. Ndërkohë, kisha mundur t'i njihja mirë sllavët, sa nuk i besoja më asnjë zotësie të tyre. Por, përsëri po i kapërcejmë ngjarjet.

KREU II

MALI I ZI DHE SUNDIMTARËT E TIJ

Në sytë e një udhëtari të rastit, ngjarjet duken pa kuptim kur ai nuk ka dijeni për ato që kanë ndodhur më parë. Është njësoj si të shkëputësh disa fjali nga mesi i një libri që nuk e ke lexuar. Prandaj, është e domosdoshme të flasim shkurt për të kaluarën e Malit të Zi, para se të ecim më tutje. Kjo është në të vërtetë kyçi i shumë problemeve të Lindjes së Afërme, sepse në këtë pëllëmbë vend, shohim lojën shekullore për sundim midis Austrisë dhe Rusisë, midis teutonëve dhe sllavëve.

Në vitin 1900*, Mali i Zi ishte thuajse sa Jorkshairi në Angli, dhe numëronte rreth 30 fise. Nahija e Malit të Zi të vjetër ishte e vogël dhe përfshinte kryesisht Cetinjën, Najgushin, Rijekën dhe Kçevon. Në shekullin XVIII këtyre iu shtua vullnetarisht grupi i Bërdës,** me qëllim që të luftonin së bashku kundër turqve. Ata ishin kryesisht prej gjak shqiptari; në kohën e aneksimit qenë katolikë, por paskëta u kthyen ortodoksë. Vlen të theksohet se ata po u bëjnë një qëndresë të ashpër përpjekjeve të Serbisë për t'i aneksuar. Së fundi, vijën territoret e mëdha, disa prej të cilave tërësisht shqiptare, që me vendim të Traktatit të Berlinit iu aneksuan Malit të Zi më 1878. Me gjithë përpjekjet e qeverisë malazise, shumë prej tyre nuk janë sllavizuar në asnjë mënyrë.

Përralla e përsëritur shpeshherë, se Malin e Zi gjoja e kanë themeluar refugjatët nga Kosova, është vetëm një mit, për arsye se lufta për Kosovën u bë një shekull më përpara, më 1389. Në vazhdim të vijës së drejtë të trashëgimisë, malazeztë dalin shumë më tepër boshnjakë, hercegovinas dhe shqiptarë, se sa serbë nga Serbia. Bosnja dhe Hercegovina kanë qenë të

* Në vitin 1900 — është gabim shtypi në libër, viti duhet të jetë 1600.

** Grupi i Bërdës — krahinë malore, që shtrihet në verilindje të vijës Nikshiq-Shpuzë.

pavarura nga Mbretëria e vjetër Serbe, gjë që shpjegon qartë mospranimin e Malit të Zi për t'u bashkuar sot me serbët.

Më 1680 patriarku Arsenius, i cili kishte vendosur të pranonte mburojën e Austrisë, mërgoi në Karlovac së bashku me shumicën e besnikëve të tij. Mirëpo rrota e fatit vërtitet në mënyrë të çuditshme. Më se një herë serbët ia detyrojnë ekzistencën e tyre ndërhyrjes austriake. Turqit dhanë leje që të emërohej një patriark tjetër serb, e megjithatë, ndikimi serb në këto zona u venit shumë shpejt, dhe po kaq shpejt shqiptarët u rivendosën në trojet, prej ku stërgjyshërit e tyre qenë dëbuar me forcë. Më 1769 fanariotët e shtypën plotësisht patriarkatin serb, sepse ata gjithmonë kishin lakmuar që Greqia të shtrihej në tërë gadishullin.

Ja çfarë shkruan i dërguari i Austrisë:

«Këtë që po shkruaj më poshtë ma tregoi një murg malazias, dhe mendoj se ia vlen të mbahet parasysh. Pak kohë pas mbarimit të Luftës Ruse, në vitin 1773, mitropoliti dhe disa murgj hartuan një plan për rindërtimin e Perandorisë së Vjetër Serbe, që përfshinte, përveç Bullgarisë, Serbisë, Shqipërisë së Veriut, Dalmacisë dhe Bosnjes, edhe Banatin e Karlstadit dhe Slloveninë. Në një çast të caktuar, ortodoksët duhej t'u binin turqve në shkallë të gjerë në të gjithë territorin, po kështu ishte vendosur që të spastrohej nga oficerët e huaj i gjithë territori brenda kufijve të perandorisë. Thuhet se me këtë plan ishte dakord i ndjeri, peshkopi ortodoks i Karlstadit, Jaksiç, i cili mbajti një letërkëmbim me mitropolitin e Malit të Zi me anën e priftërinjve... *Megjithëse zbatimi i një plani të tillë është shumë i vështirë, përsëri ky projekt nuk duhet lënë pa u marrë në konsideratë.*»

Pra, siç shohim, ambicja e Petroviçëve për të formuar Serbinë e Madhe dhe për ta sunduar atë, ishte përpunuar shumë kohë para se Serbia të fitonte pavarësinë, madje shumë kohë para se të dilnin në skenë Karagjorgjeviçët. Kjo shpjegon mjaft ngjarje të cilat kanë ndodhur që në atë kohë.

Rusia dhe Austria arritën në njërën nga «marrëveshjet» e tyre të shumta dhe së bashku i shpallën luftë Turqisë më 1788, duke shpallur se qëllimi i tyre ishte t'i jepnin fund sundimit të sulltanit. Së toku ato nxitën malazeztë të krijonin incidente kufitare me Turqinë. Mirëpo, meqë nuk u besonte malazezve, i dërguari austriak shkruante: «Ne mund të mbështetemi shumë më fort te besa dhe te guximi i shqiptarëve katolikë të Bërdës, tek ata që janë të shumtë në numër, si Bjelopavliçët, Piperët, Kuçët, Vasojeviçët, malësorët e Kelmendit e të Hotit,

etj. që mund të nxjerrin një forcë prej 20000 luftëtarësh fort trima, sesa te malazeztë». Ky është një pasazh që paraqet mjaft interes, sepse shumë nga këto fise shqiptare kanë rënë sot nën sundimin malazias, janë sllavizuar plotësisht dhe janë përfshirë në kishën ortodokse.

Disa nga këto fise vërtet e përkrahën Austrinë, ndërsa ajo i la në baltë, kur nënshkroi paqen më 1791, pas së cilës ata vuajtën ndëshkimin e turqve. Një pjesë e kelmendasve nuk guxuan të ktheheshin më në trojet e tyre dhe u vendosën në Hungari, e stërnipërit e tyre jetojnë edhe sot e kësaj dite atje.

Pas Danilos* erdhi në fron Nikolla I, mbreti i sotëm i Malit të Zi, i biri i vojvodës Mirko.

Nikolla është njeri nga më të shquarit ndër gjithë Petroviçët. I fundmi i krerëve mesjetarë të Evropës, mbeturinë e kohës së shkuar, ai është personifikim i cilësive të mira e të këqija të racës së tij. Me gjithë botëkuptimin tepër të kufizuar të tij, politikani ballkanas mund të verë në lëvizje një mprehtësi të pakufishme, vetëm e vetëm për t'ia hedhur kundërshtarit të tij dhe për të përfituar sadopak, duke lënë në të njëjtën kohë krejtësisht në harresë çështjet e mëdha.

I pajisur me kulturë perëndimore shumë më mirë se gjithë paraardhësit e tij, knjaz Nikolla fitoi autoritet të madh te nënshhtetasit e tij të paditur brenda një kohe shumë të shkurtër, dhe në lojën e madhe të politikës së Lindjes së Afërme vinte i dyti, pas Abdyl Hamidit për intriga dhe dinakëri.

Që në fillim të karrierës ai kishte vetëm një qëllim: rindërtimin e Perandorisë së madhe Serbe, me dinastinë e Petroviçëve në fron. Ky ishte synimi i tij në jetë, dhe ai bëri ç'ishte e mundur për t'ia ngulur këtë gjë në mendje edhe popullit të tij.

Ai i detyroi të gjithë të mbanin festen karakteristike kombëtare, që e kishte shpikur vlladika Petri II. Të gjithë fëmijëve u mësohej në shkollë se kordoni i kuq rreth festes donte të thoshte gjak që duhej marrë. Për të nxitur frymën nacionaliste, ai krijoi nga një këngë *Kollo* për secilën fis, që do të shoqëronte vallen gjatë manifestimeve popullore. Ndërsa për gjithë vendin në tërësi, ai shkroi këngën kombëtare më të përhapur.

«Përpara, përpara, Prizrenin ta shikoj,
Se është imi, në vendin tim do shkoj!»

* Nipi i Radanit ose i vlladikës Petri i Dytë (që sundoi deri më 1851 dhe që e la trashëgimtar Danilon). Daniloja u shpall princ me ndërhyrjen ruse dhe u vra më 1860, duke lënë vetëm dy vajza.

Froni dhe kështjella e car Dushanit në Prizren zaptuan mendjen e kombit.

Dhe për të siguruar bindjen e këshillit të pleqve të vendit, ai emëroi kryetar të këshillit të atin, të tmerrshmin vojvodë Mirko, dhe i zgjodhi vetë të gjithë anëtarët e tjerë.

Në qershor të vitit 1876, princi Milan i Serbisë i shpalli luftë Turqisë. Knjaz Nikolla, i cili nuk kishte pranuar ta njihte Milanin si udhëheqës të popujve serbë dhe e shihte tërë smirë, e shpalli luftën që të nesërmen.

Ideja e Serbisë së Madhe kishte filluar tashmë të shkaktonte rivalitet.

Mirëpo Traktati i Berlinit i përmbysi punët. Anglia ishte veçanërisht antiruse dhe me anën e përfaqësuesve të saj, lordit Bikensfeld dhe lordit Sollsberi, nguli këmbë për t'ia besuar qeverisë austriake për administrim shumicën e pushtimeve të Malit të Zi në Hercegovinë. «Miku i vetëm i carit» shikohej me dyshim. Fatkeqësisht, Malit të Zi iu dhanë për kompensim kryesisht toka shqiptare. Kjo ishte një padrejtësi e madhe. Ashtu si malazeztë, edhe shqiptarët kishin bërë një luftë këmbëngulëse për kombësinë e tyre dhe nuk e kishin humbur kurrë autonominë e tyre lokale. Ata bënë një qëndresë të ashpër dhe nuk e lejuan Malin e Zi të pushtonte as Plavën, as Gucinë dhe as Tuzin. Fuqitë e Mëdha u munduan ta zgjidhnin këtë me një akt akoma më të padrejtë. Zoti Gledstoun që kishte pak, për të mos thënë aspak, përvojë vetjake në kishën ortodokse, ushqente një adhurim të jashtëzakonshëm për të, dhe i molepsur nga ideja e gabuar se çdo mysliman ishte turk, u shpreh që Malit të Zi t'i jepej Ulqini, një qytet tërësisht shqiptar, në vend të tri qyteteve të tjera të lartpërmendura. Ky ishte një vendim veçanërisht i padrejtë, dhe tepër mizor. Edhe në kohën e kralëve serbë, Ulqini e kishte ruajtur autonominë e vet, dhe në një periudhë të caktuar ai kishte prerë edhe paratë e veta. Të gjithë udhëtarët e vjetër thonë se atje flitej gjuha shqipe. Malazeztë as nuk mundën ta merrnin dhe as që kishin ndonjë pretendim për të. Mirëpo, qyteti u detyrua të dorëzohej pas një manifestimi të madh force nga ana e flotës së Fuqive të Mëdha. Ky ka qenë, ndoshta, një nga veprimet më të shëmtuara kërcënuese që kanë kryer deri më sot Fuqitë e Mëdha.

Ulqini shqiptar iu dha armikut të përjetshëm të tij. Forca e natyrës së tij të pastër shqiptare tregohet nga fakti se ndërsa në Nikshiq, në Podgoricë dhe në Shpuzë myslimanët, serbët dhe shqiptarët u zhveshën nga çdo pasuri dhe u përzunë me forcë nga vendi i tyre, që të vdisnin urie tutje-tëhu në dhe të

huaj, siç ngjau me një pjesë shumë të madhe të tyre, malazeztë nuk guxuan të kapeshin me popullatën e madhe të Ulqinit, që ishte armike e tyre dhe, po kështu, në asnjë mënyrë nuk kanë arritur ta sllavizojnë atë. Banorët e Ulqinit edhe sot kërkojnë të ribashkohen me Shqipërinë.

Për herë të parë Mali i Zi u njoh si principatë e pavarur nga Traktati i Berlinit, kurse në vitin 1880 Serbia u bë mbretëri. Knjaz Nikolla dhe malazeztë e tij, të cilët pranuan të njihnin princin Milan si udhëheqës të kombit serb, u bënë pikë e vrer. U përforcua rivaliteti armiqësor midis dy degëve të racës serbe. Knjaz Nikolla u përpoq me anë të pinjollëve të shumtë të tij të lidhte një varg të shënuar krushqish me të gjitha Fuqitë e Mëdha.

KREU III

PËRSHTYPJET E PARA PËR VENDIN DHE NJERËZIT

Në vitin 1901 vizitova Malin e Zi dhe, duke lundruar përmes liqenit, dola në Shkodër. Shkodra më befasoï dhe më bëri menjëherë për vete. Ishte plot ngjyrë, plot jetë dhe art. Njerëzit ishin shumë të shoqërueshëm e punëtorë dhe nuk e harxhonin tërë kohën duke pirë raki ose duke u vërdallisur poshtë e lart rrugëve, siç ndodhte në Cetinjë. Ata ishin shumë njerëzorë, por mbi të gjitha unë doja të vizitoja malësitë shqiptare. Mirëpo, konsulli ynë ishte rishtar në atë vend. Ai u këshillua me kolegun e tij austriak, dhe, meqë në atë kohë Austria i mbante ato male për zotërime të vetat, ai iu përgjigj me një ton emfatik duke i thënë se ai udhëtim ishte diçka e pamundur për mua.

Në atë kohë nuk kishte ndonjë krizë politike, por qarkullonin zëra se një farë Kastrioti në Paris, i cili pretendonte se rridhte nga dera e të madhit Skënderbe, kishte mundësi të vinte si princ i Shqipërisë, gjë që kishte ngjallur një farë ngazëllimi në zemrat e shqiptarëve. Flitej nën zë për shpresën e shpalljes së pavarësisë.

Në Mal të Zi nuk flitej për gjë tjetër veç për Serbinë e Madhe.

Gjatë pushimeve që bëra në vitin 1901 nuk pati asgjë tjetër për t'u shënuar. Viti i ardhshëm ishte plot ngjarje.

KREU IV

SERBIA DHE RRUGA PËR ATJE

Malin e Zi e kisha vizituar dy herë dhe aty kisha dëgjuar mjaft për Serbinë e Madhe. Për të mësuar të kaluarën e këtij vendi sipas midesë serbe, mjafton të lexosh cilindo numër gazete ose libër me balada. Tani, malazeztë trupmëdhenj shë-tisnin poshtë e lart rrugës kryesore të Cetinjës, veshur me kos-tumet më të zbukuruara popullore të Evropës, pinin sasi të pallogaritshme kafeje e rakië dhe bisedonin për ato kohë të lavdishme, kur të gjithë serbët do të bashkoheshin përsëri nën drejtimin e gospodar Nikitës. Mirëpo, mua nuk më kishte ka-pur veshi ndonjë lajm se ata po ndërmerrenin hapa aktivë në këtë drejtim, për të krijuar këtë parajsë tokësore.

Afruan pushimet e vitit 1902. Vendosa të futesha më në thellësi të vendit dhe ta shihja vetë Serbinë. Së pari, më duhej të shkoja në Mal të Zi, ku mund të merrja të dhëna dhe të bëja njohjet e rastit. Në Angli asnjëri nuk ishte në gjendje të më thoshte diçka për Serbinë dhe arrita të shtija në dorë vetëm një libër të kohëve të fundit, që bënte fjalë për këtë çështje. Edhe ky libër nuk më solli ndonjë gjë, sepse gëzimi i vërtetë i udhëtimit fillon në çastin kur zhytesh në të panjo-hurën e vendit ku shkon, dhe këtë lloj gëzimi ishte ende e mundshme ta shijoje në Evropën e vitit 1902. Nga Almanaku i Uitejkerit mësova se për çdo letërnjoftim duhej marrë vizë në legatën serbe, për ku u nisa me ngut.

Kurrë në jetën time nuk kisha udhëtuar pa pasaportë, sepse rrezikun e ndonjë aksidenti e ke kurdoherë pas, qoftë edhe kur vete në një vend kaq të afërt siç është Parisi, letërnjoftimi mund të të vlejë. Por vizë speciale nuk kisha kërkuar kurrë më parë.

Prandaj, me një ndjenjë gëzimi në kraharor i rashë ziles së legatës dhe me buzëqeshje, i zgjata pasaportën dhe një kër-kesë për vizë një të riu që më futi brenda. Ai më tha të prisja

dhe unë ashtu bëra. Prita dhe, megjithëse dija diçka për Lindjen e Afërme, zura të vrisja mendjen se çfarë çështjesh të mëdha të politikës botërore e kishin mbërthyer ambasadorin serb që më la të prisja kaq gjatë. Njerëz të ndryshëm kurrëtarë zgjatnin kokat nga dera gjysmë e hapur për të më parë dhe tërhiqeshin menjëherë sapo ktheja kokën nga ata. Më në fund, më thirrën te z. Miliçeviç.

Ai më vështroi vëngër dhe më pyeti përse doja të shkoja në Serbi. Përgjigja ime se tani që kisha parë Malin e Zi, kisha dëshirë të shihja edhe vende të tjera sllave, nuk i pëlqeu hiç. Mirëpo, duke dashur t'i bëja qejfin e ta paqësoja, unë i prisha edhe më tepër punë vetes, duke i folur gjerë e gjatë për ato që kisha parë e kisha dëgjuar në Mal të Zi. E ku ta dija unë në atë kohë, se gjëja që një shtet sllav urren më shumë në këtë botë është një shtet tjetër sllav.

Ai nguli këmbë që t'i jepja «të dhëna të sakta».

— Çfarë doni të bëni atje?

— Dua të shëtis, të vizitoj, të bëj fotografi dhe të mbledh relikte të rralla.

Ai m'u përgjigj i vrenjtur se kishte edhe vende të tjera në Evropë, ku mund të bëheshin të gjitha ato gjëra.

Nuk munda ta kuptoja qëndrimin e tij. Në atë kohë unë kisha mendimin se vendet e huaja i prisnin turistët krahëhapur dhe hotelet mezi ç'prisnin t'u venin miq. Edhe ai, nga ana tjetër, nuk arriti të më kuptonte fare, sepse ashtu si shumë ballkanas të tjerë, edhe ai nuk mund ta konceptonte një udhëtim pa ndonjë qëllim politik.

As që më shkonte nëpër mend se vrasjet mbi të cilat do të ngrihej Serbia e Madhe, kishin filluar të kurdiseshin që në atë kohë.

I bëra një pyetje drejtpërdrejt:

— Mos vallë është kaq i rrezikshëm udhëtimi në Serbi?

Kisha qëlluar në shenjë.

— Jo, aspak! — m'u përgjigj me të shpejtë.

— Atëherë, përse nuk mund të shkoj atje?

Pasi dhamë e morëm për një copë herë, ai pranoi të më lëshonte vizën, me kusht që të paraqitesha drejt e te konsulli anglez në Beograd dhe të mos bëja asnjë veprim pa u këshilluar me të. Firmosi dokumentin, duke shtuar se ai nuk mbante asnjë lloj përgjegjësie. Pagova ç'kisha për të paguar dhe u largova fitimtare, pa ditur asgjë për folenë e grerëzave, ku po më lejonin të hyja.

Asokohe nuk dija shumë gjëra për politikën serbe, përveç

faktit se krali Aleksandër nuk gëzonte popullaritet për shkak të një martese fatmjerë që kishte bërë, dhe për hir të një përjekjeje akoma më fatmjerë të mbretëreshës Draga, për të lënë një trashëgimtar të rremë në fron, duke pretenduar se ishte shtatzënë. Dija gjithashtu që i ati kishte pasur një karrierë melodramatike dhe se historia e Serbisë gjatë gjithë periudhës së pavarësisë nuk kishte qenë gjë tjetër veçse një vazhdë e gjatë gjakmarrjesh midis dinastive rivale të Karagjorgjeviçëve dhe Obrenoviçëve, asnjëra prej të cilave nuk dukej të gëzonte popullaritet në Mal të Zi. Shkova drejt e në Cetinjë dhe ua bëra të njohur disa njerëzve planin tim për të vizituar Serbinë. Për habinë time të madhe nuk doli asnjëri që të më bënte njohjet e rastit, por, meqë ata më kishin përsëritur vazhdimisht se malazeztë ishin ajka e kombit serb dhe se pikërisht ata do ta çonin Serbinë drejt lavdisë, kisha besim se ishte e mjaftueshme të përmendja emrin e Malit të Zi e të njohurive që kisha për të, për të siguruar kudo mikëpritje.

Pranë derës së Manastirit të Cetinjës ndodhet varri i njërit prej Karagjorgjeviçëve dhe prifti që ma tregoi atë, më tha gjithashtu se familjet Petroviç dhe Karagjorgjeviç kanë shkuar shumë mirë me njëra-tjetrën. Knjaz Nikolla i kishte dhënë të bijën, Zorka, Petër Karagjorgjeviçit, pretenduesit të fronit të Serbisë më 1883; ai më tha edhe se prifti i ri pati jetuar në Cetinjë, ku bënë edhe tre fëmijë; por pas vdekjes së Zorkës, më 1890, vjehrrin dhe dhëndrin qenë kacafytur shumë keq për çështje parash, dhe që nga ajo kohë Petri as që ishte dukur më në Mal të Zi. Paraqet njëfarë interesi edhe fakti që princi trashëgimtar i Serbisë, Aleksandri, ka lindur në Cetinjë, pra tani kur shohim se ai po përpiqet të rrëmbejë fronin e gjyshit të tij, por për këtë çështje do të flasim më vonë. Më 1902 kjo ishte një ëndërr e parakohshme.

Duhet të pranoj haptas se në atë kohë unë nuk e njihja Ballkanin dhe të gjitha këto gjëra i merrja me shaka, ato më dukeshin si një operetë komike. Porse operetat komike të Ballkanit shkruhen me gjak.

Për mua Ballkani do të ishte në të ardhmen një sfinks, një parashtrues i zellshëm gjëzash, çdonjëra prej të cilave do të më çonte te një lëmsh tjetër akoma më i ngatërruar, që do të donte shumë kohë për t'u shpleksur.

KREU V

Ç'NGJAU NË VITIN 1903

Në fillim të vitit 1903 më erdhi një ftesë për të qëndruar me disa nga partizanët e Karagjorgjeviçëve në Serbi. Nuk kishte ardhur akoma koha e asaj «diçkaje» që do të ndodhte. Ime motër kishte dëshirë të udhëtonte me mua, por me ç'kisha provuar unë mbi kurriz vitin që shkoi, nuk më takonte ta merrje me vete në Serbi. Kur je fare vetëm, mund ta rrezikosh veten pa ngurrim, po kurrsesi nuk mund të tërheqësh në rrezik një tjetër. Shkuam në Mal të Zi. Në Cetinjë bënte shumë vapë. Ishte data 11 qershor. Po pushonim në njërën nga dhomat e pasme të hotelit, kur dëgjuam një trokitje të fortë në derë dhe zërin e kamerierit Ivan, që thërriste: «Telegram, telegram!». Brofëm në këmbë të frikësuar se mos ishte ndonjë lajm i keq dhe sapo hapëm derën, Stvaneja thirri i shqetësuar:

— Mbreti dhe mbretëresha e Serbisë vdiqën!

Mendja ime hyri menjëherë në veprim dhe fluturoi te «diçkaja». Ajo kishte ndodhur, kriza kishte filluar. Pa prituri të mendohesha asnjë minutë, i thashë:

— Atëherë Petër Karagjorgjeviçi do të bëhet mbret!

— Jo, jo, — thirri Ivani. — Të gjithë thonë se mbret do të bëhet princ Mirkoja!

— Jo, — ia ktheva me vendosmëri, sepse isha më se e sigurtë, — Mirkoja nuk bëhet mbret. — Pastaj e pyeta: — Po si vdiqën?

— Vetëm perëndia e di këtë gjë — m'u përgjigj. — Disa thonë se u zunë, njëri vrau tjetrin e pastaj edhe veten. Dhe këtu kemi për të qenë kur Mirkoja të bëhet mbret, gospodica. Edhe gazeta e djeshme kishte një artikull për këtë.

Ai u zhduk me vrap e më solli gazetën. Tani më vjen keq që nuk e mora shënim emrin e asaj gazete, por jam e sigurtë se ajo botonte një artikull, i cili e quante Mirkon trashëgimtar të fronit serb, në rast se Aleksandri vdiste pa lënë fëmijë.

Cetinja ishte e shqetësuar si kurrë ndonjëherë. Zakonisht ajo mjaftohej vetëm me nga një telegram në ditë, që i vinte nga Zyra e Korrespondencës, ndërsa tani postierët venin e vinin në zyrën e postëtelegrafit, ku buletinet e lajmeve vinin lukishin vdekur papandehur, shkaku nuk dihej, porse në trupat e kufomave kishte plagë plumbash.

Hollësitë e plota arritën më vonë. Sipas gazetave të Beogradit kishte tre muaj që kishin filluar përgatitjet për kryengritje, dhe anembanë vendit ishin ngritur komitete të fshehta. Vendimi për vrasjen e mbretit dhe të mbretëreshës ishte marrë nga korpusi i Oficerëve në Beograd, dhe kjo detyrë i ishte caktuar Regjimentit të 6-të të Këmbësorisë. Banda e vrasësve kishte hyrë në pallat në orën 11.00 të natës; meqë mbreti nuk kishte pranuar të hapte derën e dhomës së gjumit, koloneli Naumoviç i kishte vënë dinamitin dhe kishte mbetur edhe vetë i vrarë nga shpërthimi.

Pas kësaj aty ishte bërë një kasaphanë e vërtetë. Trupat e viktimave, të bërë shoshë nga plumbat, por akoma të gjallë, u flakën nga dritarja. Draga, për fatin e saj, vdiq menjëhere, ndërsa i ndjeri Aleksandër lëngoi deri në orën 4 të mëngjesit.

Sipas njoftimeve të ditës, vrasësit i kishte zënë vera edhe gjaku, dhe ishin lëshuar mbi trupat e viktimave, duke i gjymtuar në mënyrën më të ndyrë; ata arritën deri atje sa të prisnin copa lëkure nga trupi i Dragës, të cilat i thanë dhe i ruajtën si trofe. Më vonë, një oficer i pati treguar një mikut tim një të njërën nga ato copa, të cilën ai e ruante në një bllok shënimesh që mbante me vete.

Kur kisha shkruar librin tim të parë për Ballkanin më qe dashur të trokisja derë më derë te botuesit, të cilët më thoshin se meqë në Angli njerëzit nuk kishin as më të voglin interes për çështjet ballkanike, ata nuk mund ta pranonin librin, megjithëse, shtonin me mirësjellje, si libër udhëtimesh, në gjininë e tij, ai nuk ishte i keq. Mirëpo vrasja e një mbreti e preku menjëherë zemrën e anglezëve, dhe, për rrjedhojë, unë arrita ta shes librin menjëherë.

U largova nga Berani dhe hyra në tokat shqiptare. Këto toka që serbët i quanin me aq dashuri «Stara Srbija» (Serbia e Vjetër), në fakt kanë qenë zënë nga serbët vetëm për një periudhë të shkurtër kohe.

Serbët, ose më mirë stërgjyshërit e tyre sllavë, vërshuan me hordhi të tëra në Gadishullin Ballkanik në shekullin VI e VII, duke u dyndur mbi banorët autoktonë — shqiptarët. Me-

gjithëse u përpoqën jashtë mase, ata nuk arritën t'i shfarosnin shqiptarët. Mund të themi se banori rrënjës nuk mund të shfaroset kurrë. Shqiptarët janë njerëz me të cilët është vështirë të merresh vesh me këtë rrugë. . . Serbia e arriti kulmin e lavdisë nën sundimin e car Stefan Dushanit. Ai vdiq në vitin 1356, pa lënë trashëgimtar të aftë për të sunduar në këtë perandori heterogjene, që ai kishte mundur ta krijonte gjatë 20 vjetëve të sundimit të tij. Atëherë krerët feudalë, rivalë të Serbisë, u ndeshën me njëri-tjetrin për pushtet dhe perandoria u copëtua shpejt. Nga ky lëmsh Shqipëria u shkëput pothuajse menjëherë dhe doli si principatë më vete nën sundimin e Balshajve. Dhe që nga ajo kohë, Shqipëria asnjëherë nuk ka rënë plotësisht nën sundimin serb. Pushtimi turk i shpartalloi serbët, ndërsa shqiptarët e forcuan edhe më tepër pushtetin e tyre.

Nga Berani udha të çonte nëpër Arnautllëk*. Kaluam nëpër Rugovë, e vetëm më vonë mora vesh se Rugovës i kishte dalë nami si një nga krahinat më të rrezikshme në territorin turk dhe se mund të kishte rreth 20 vjet që në këtë anë nuk kishte shkelur këmbë udhëtari evropian. Anës rrugës ngrihej një xhami e keqe prej druri. Ndalua. Njerëzit ishin mjaft të sjellshëm dhe miqësorë, dhe dikush prej tyre na dha edhe kafe. Pas 16 orësh udhëtimi tepër të lodhshëm, arritëm në Pejë. Kishte rënë nata me kohë, kur trokitëm në portat e patriarkisë.

Vajtja ime aty u ra si rrufe patriarkisë dhe autoriteteve turke të cilat kishin urdhër të ndalohej hyrja e të huajve në këtë krahinë dhe kishin mbyllur rrugët kryesore. Atyre as që u kishte shkuar ndër mend se do të dilte ndonjë i çmendur që të vinte këtu duke prerë kufirin malazias nga ana e Rugovës.

Ushtria kishte pushtuar tërë krahinën. Rreth 30 mijë trupa turke ishin dislokuar në viset fqinje. Më thanë se kohët e fundit atje ishin zhvilluar luftime të mëdha. Që nga koha e Traktatit të Berlinit, shqiptarët s'kishin pushuar së luftuari për t'i shkukur Turqisë autonominë e vendit të tyre dhe për t'u njohur si komb. Peja, Gjakova dhe Prizreni ishin qendrat e Lidhjes Shqiptare. Sipas një njoftimi të qeverisë angleze të gushtit 1880, shumica dërrmuese e popullsisë së krahinës ishte shqiptare:

«Shqiptarët janë shumë më tepër në numër se sa serbët, të cilët janë të paktë në Fushën e Kosovës dhe në sanxhakun e

* Turq. krahinat shqiptare, në këtë rast është për viset e Kosovës, e cila që në shek. XIV u quajt nga osmanët si vendi i shqiptarëve.

Novi Pazarit. Popullsia shqiptare në vilajetin e Kosovës tashti vonë (1880) është shtuar edhe më nga ardhja e mijëra të shpërngulurve nga viset, të cilat sipas Traktatit të Berlinit tashti janë nën zotërimin serb, por që para këtij Traktati kanë qenë të banuara vetëm prej pasardhësve të 12 fiseve geqe.»

Doktrina themelore e idesë së Serbisë së Madhe është mospranimi i faktit se historia ka ekzistuar edhe para krijimit të Perandorisë Serbe, dhe se trojet e Ballkanit kanë pasur zotëri edhe para ardhjes së serbëve. Ajo që e tërbon më tepër një «serbomadh», kur këmbëngul që t'i drejtohet historisë, është t'i thuash se është një popull tjetër që ka pretendime më të vjetra për këto troje dhe se sidoqoftë, Serbia e Madhe e Stefan Dushanit nuk jetoj më shumë se 20 vjet.

Duke ndjekur këtë teori, sipas së cilës pjesa më e madhe e Gadishullit Ballkanik qenka trashëgimi e ligjshme e serbëve (të cilët nisën të hynin në këto troje në një kohë që nuk shkon dot para shekullit të katërt të erës sonë*), serbët u sollën me një ashpërsi të tmerrshme ndaj banorëve të trojeve që ata aneksuan në vitin 1878, duke ndjekur nga vatrat e tyre turma të mëdha njerëzish të skamur e të uritur, një pjesë e madhe e të cilëve u tretën e humbën rrugëve.

Urrejtja midis shqiptarëve dhe serbëve u qindfishua. Ata që mbetën dhe pasardhësit e tyre luftuan pa pushim për të mbrojtur të gjitha tokat që ende i zotëronin dhe për të rimarrë, po të mundnin, ato që kishin humbur. Zbatimi i planit të lordit Ficmoris do t'i kishte kursyer Ballkanit e ndoshta Evropës shumë gjakderdhje e urrejtje.

Kur arrita në vend, në vitin 1903, turqit kishin dërguar atje një ekspeditë të madhe ndëshkimore për të detyruar popullin të paguante xhelepin për bagëtinë dhe për të futur një politikë të re «reformiste» në vilajetin e Kosovës, sipas urdhrit të Evropës.

Shqiptarët e dinin fort mirë se këto të ashtuquajtura reforma kishin, në fund të fundit, për qëllim që t'u hapnin rrugën planeve të pansllavizmit rus. Ata e dinin po aq mirë se edhe sikur një grusht serbësh të jetonte në aksh vend, rusët do të pretendonin se ky vend ishte serb, dhe do të vinin të gjitha forcat për ta konfirmuar këtë pretendim; këto «reforma» në fakt, nënkuptonin futjen e konsullatave serbe dhe ruse, ngritjen e shkollave serbe dhe të kishave nën mbrojtjen ruse,

* në të vërtetë fiset sllave në Ballkan filluan të ngulen vetëm nga fillimi i shekullit VII.

ngritjen e kolonive serbe dhe, në fund të fundit, aneksimin e plotë të vendit. Rusia bënte përpjekje shumë aktive për të përligjur pretendimet e reja të Serbisë. Konsulli rus në Mitrovicë, zoti Shçerbina, kishte marrë pjesë personalisht në një luftim kundër shqiptarëve ku, sipas njoftimeve, ishte plagosur për vdekje kur po shtinte me top.

Në të vërtetë, Rusia, e sigurt për heqjen nga skena të Obrenoviçëve proaustriakë dhe në lidhje të ngushta me Malin e Zi dhe Bullgarinë, po kurdiste një tjetër goditje në Ballkan. Kësaj gjëje Shqipëria po i kundërvihej. Të ndodhur nën presionin e Fuqive të Mëdha, turqit po bënë çmos t'i ftohnin gjakrat për ta shtyrë sa të ishte e mundur përleshjen përfundimtare që afrohej dita-ditës. Ata arrestuan një numër krerësh dhe dhanë disa dënime për të pagur për vdekjen e Shçerbinës. Mirëpo, kur një konsull ka qejf dhe me kokën e vet shkon të marrë pjesë në një luftë lokale, për pasojat përgjegjës është vetë ai.

Kisha arritur atje në një çast kritik. Autoritetet turke dërguan telegrame anakënd vendit për t'i mësuar si të vepronin me mua. Shoqëruesi im malazias gjithashtu ishte në ankth dhe m'u lut që në asnjë mënyrë të mos më shpëtonte goja e të tregoja se nga ishte.

Nga maja e një kodrine pashë fushimin turk që kishte ngritur tendat tejmbanë fushës.

Igumeni dhe disa murgj e vizitorë më treguan mendimin e serbëve për këtë punë. Këto toka ata i quanin të drejta të patjetërsueshme të Serbisë, vetëm pse Sveti Kralj* ishte kurozuar në këtë kishë këtu e gjashtë shekuj të shkuar. Mezi po i prisnin ushtritë ruse që do të zhduknin gjithçka joserbe. Shçerbina ishte bërë Krishti i dytë për ta, sepse kishte dhënë jetën për shpëtimin e tyre, prandaj edhe portretin e tij e ruanin si gjë të vyer. Jo më larg se një vit më parë, Rusia kishte ngulur këmbë të vendoste një konsull në Mitrovicë, kundër vullnetit të qeverisë turke. Kështu ishin ngjallur përsëri shpresat serbe. Dhe ka të ngjarë që vetëm prania e tij ta ketë provokuar atë luftë.

Megjithatë, igumeni e murgjit e pranuan se turqit ishin përgjegjës për gjendjen e Shqipërisë, sepse ata kishin ndaluar hapjen e shkollave shqipe dhe e kishin penguar përparimin; një Shqipëri e pavarur do të ishte gjëja më e mirë.

* Serb. Mbreti i Shenjtë, siç është quajtur Stefan Deçani, i ati i Stefan Dushanit.

Ndërkohë, autoritetet turke nuk dinin si të vepronin me mua dhe më thirrën në konak për të më kontrolluar letërnjoftimin. Aty prita me orë të tëra. Kishte plot njerëz që kërkonin leje për të udhëtuar. Njerëz të këputur, që gati po vdisnin në këmbë nga të pangrënët, luteshin të nxirrnin nga një leje për të shkuar në një rreth tjetër për të kërkuar ndonjë punë në bujqësi, por edhe kjo u mohoj. Turqit ishin me nerva të ngritura dhe, pa dyshim, duhej ta dinin se ishin në pragun e krizës.

Më në fund pashai nuk ma pranoi kërkesën që kisha bërë për të shkuar në Gjakovë. Dhe kishte të drejtë, sepse vazhdonin luftimet midis trupave turke dhe shqiptare. Më lejuan vetëm të vizitoja Manastirin e Deçanit, që mbante disa orë me kalë prej aty. Deçani është një nga rajonet që paraqet vështirësi për vendosjen e kufijve të drejtë. Edhe pse ndodhet në një krahinë tërësisht shqiptare, ai përbën një nga monumentet e Perandorisë së lashtë Serbe. Aty ndodhen reliket e Sveti Kralit, mbretit Stefan Deçani, të cilin sipas gojëdhënave, e mbytën në kullën e tij në Zveçan, në vitin 1336, me urdhër të të birit, carit të madh Stefan Dushanit, që i zuri vendin dhe që u vra për vete në vitin 1356.

Në manastir ishte vendosur një oficer turk me ca nizamë, mirëpo dukej sheshit se ata pak murgjër e studiues që ishin aty, kishin më tepër besim te një truprojë shqiptarësh myslimanë, që banonin aty afër, sesa te turqit. Ata po prisnin disa murgj rusë, që do të vinin së shpejti nga mali Atios. Në fakt, Rusia po vendoste nënshtetas të saj atje, për t'i pasur si shkas për ndërhyrje.

U ktheva në Londër dhe pa kaluar shumë kohë lexova në gazetën «The Times» se në Maqedoni ishin shuar turbullirat. Por, duke u kujtuar se në Pejë më patën thënë që ato akoma nuk kishin filluar, i shkrova një letër gazetës «The Times» dhe i tregova për këtë gjë. Mirëpo, ata qenkëshin të informuar shumë mirë e nuk kishin si të botonin njoftimin tim. A nuk e kishin tërhequr dhe korrespondentin? Dhe ashtu siç më kishte thënë Rizovi, në gusht shpërtheu një kryengritje e përgjithshme bullgare në të gjithë Maqedoninë.

KREU VI

MAQEDONIA NË VITET 1903-1904

Kryengritja e vitit 1903 në Maqedoni, siç ndodh vazhdimisht në të tilla lëvizje, u përgatit së prapthi. Historia e kësaj lëvizjeje është përshkruar me hollësi kushedi sa herë. Prandaj dua të them vetëm këtë: në vend që tërë fshatrat të ngriheshin njëherësh, ata u ngritën njëri pas tjetrit, duke u dhënë mundësi trupave turke të arrinin në kohë, në secilin fshat dhe të digjin e të plaçkitnin, siç ishte e zakonshme në të tilla ekspedita ndëshkimore. Mijëra refugjatë u arratisën në Bullgari dhe organizuan çeta komitësh në territorin bullgar, të cilat për njëfarë kohe kryen luftime të çrregullta guerile kundër forcave turke.

Në të hyrë të dimrit, kryengritja maqedonase u shua dhe vendin e shkatërruar e pllakosi një mjerim i tmerrshëm. Në dhjetor, duke më konsideruar tashmë si një person, që ka ca përvojë nga jeta e Ballkanit, i sapoformuari Komitet i Ndimave Maqedonase më kërkoi që të punoja edhe unë atje, nën drejtimin e tij. Kjo ftesë më erdhi krejt papritur dhe shprehte njëfarë dëshpërimi.

Ndërkohë, unë kisha mbaruar dy muajt e lejes. Deri tani kurrë nuk më ishte bërë ftesë për të marrë pjesë në ndonjë punë të tillë shoqërore dhe nuk mund ta shprehja me fjalë sa dëshirë kisha të shkoja. Rrethanat më kishin detyruar të refuzoja sa e sa ftesa. Por tani që i kisha mbushur të dyzetat, ky do të ishte ndoshta rasti i fundit që më paraqitej.

Në Manastir u përpoqa të blija disa libra serbisht, meqë i isha futur mirë punës për mësimin e kësaj gjuhe. Kisha me vete edhe një fjalor dhe një libër gramatike. Por, në atë kohë propaganda serbe në Manastir ishte ende në hapat e parë, kësaj nëpër librari nuk gjeje gjë tjetër veç librave shkollorë. Bullgarët kishin ngritur një shkollë të madhe dhe një alamet kishe. Në qoftë se dikush do të thoshte se Manastiri ishte, ose

kishte të ngjarë të bëhej dikur krahinë serbe, njerëzit do ta quanin ose budalla ose të pirë. Ndeshja ishte ndërmjet grekëve e bullgarëve, as nuk shtrohej çështja për serbët. Këtu banonte një popullsi e madhe «greke», si në qytet ashtu edhe në fshat, por një pjesë shumë e madhe e tyre ishte vllahë, kishte edhe shumë shqiptarë, ndërsa pjesa tjetër ishte sllave. Ndoshta degës greke të kishës ortodokse dhe që në listat e regjistrimit numëroheshin për grekë.

Për sa i përket urrejtjes që ekzistonte midis kishës greke dhe asaj bullgare, ajo ishte aq e fortë sa është pothuajse e pamundur të kuptohet nga një evropian perëndimor, në rast shin nën sundimin turk, grekët kanë qenë kreu i të krishterëve ortodoksë. Edhe ata kanë pasur vetëm një ëndërr: rindërtimin e Perandorisë së Madhe Bizantine. Duke përdorur lloj-lloj dredhish të panumërta, ata kishin mundur t'i shtypnin dhe t'i zëvendësonin kishat e pavarura serbe dhe bullgare.

Por kur Rusia filloi të projektonte planin e pansllavizmit, nuk ushqente kurrfarë simpatie për Bizantin e Madh. Ajo e dinte fort mirë se kur ke të bësh me një fshatarësi të paditur, mjeti më i dobishëm për të ngjallur një nacionalizëm të fortë është kisha kombëtare. Në vitin 1870, sulltani krijoi me dekret Ekzarkatin Bullgar, nën presionin e Ruisë, e cila gëzonte edhe përkrahjen e fuqive të tjera, disa prej të cilave ishin të bindura se kështu ndihmonin çështjen e kristianizmit. Por në vend që të «ngjallnin kristianizmin», ata bënë që patriarku grek të shkishëronte Ekzarkun bashkë me të gjithë pasuesit e tij. Plasi kështu lufta midis dy kishave, të cilat nuk kishin asnjë grimë ndryshimi në doktrinë, në dogmë apo në shërbesë fetare. E vetmja mosmarrëveshje e tyre ishte për çështje politike dhe kombëtare.

Askush më tepër se besimtarët anglezë nuk është zhgënjyer nga të krishterët ballkanas. Kur isha në Mal të Zi, kisha dëgjuar gjithfarë përrallash se të krishterët po rënkonin nën zgjedhën turke dhe i kisha marrë për të vërteta. Kur isha në Maqedoni, mësova një të vërtetë të çuditshme; përkundrazi, ishin pikërisht kishat e Ballkanit që e mbanin në këmbë turkun. Grekët dhe serbët po organizonin banda komitësh dhe po i dërgonin në Maqedoni, jo për të «çliruar vëllezërit e tyre krishterë», kurrsesi. Kjo ishte e fundit dëshirë e tyre. Këto banda ata i dërgonin për të ndihmuar turkun për të shtypur «vëllezërit e krishterë».

E ngushëllova peshkopin bullgar të Ohrit për masakrën e tmershme që bënë turqit ndaj besimtarëve të tij. Ai m'u përgjigj me qetësi se ishte zhgënjyer. Kishte menduar se do të ishte vrarë, të paktën, gjysma e popullsisë, dhe atëherë, dashur pa dashur, Evropa do të ishte shtrënguar të ndërhynte. Ndërsa as një e katërta nuk ishte zhdukur, prandaj ai ishte i mendimit se tërë kjo lojë do të përsëritej edhe një herë. «Herën tjetër do të shohim një kasaphanë të madhe. Të gjithë konsujt dhe çdo i huaj tjetër do të vriten. Vetë e kanë fajin». Bullgaria e Madhe duhej të ngrihej me çdo kusht.

— Sipas mendimit tim, — i thashë, — sikur bullgarët të ishin ngritur më 1897, kur grekët ndodheshin të angazhuar në luftë me turkun i gjithë vendi do të qe çliruar.

Ndërsa ai m'u përgjigj me zemërim:

— Kurse unë them: më mirë të mbetemi ngaherë nën sundimin turk, sesa t'u japim mundësi grekëve të marrin makar edhe një kilometër tokë.

Më vonë takova kundërshtarin e tij, peshkopin grek. Edhe ai, nga ana e tij, m'u qa mjaft për vuajtjet e të krishterëve të gjorë nën zgjedhën turke. Edhe atij ia thashë mendimin tim, se po ta kishte ndihmuar Greqia kryengritjen maqedonase, tani të krishterët mund të ishin çliruar. Por vetëm kjo ide qe mjaft për t'i kallur tmerrin. Ai më mirë do të pëlqente që vendi i tij të ishte përgjithmonë nën suazën turke, sesa t'i lejonte ata «derra» bullgarë të merrnin qoftë edhe një pëllëmbë tokë.

Ky ishte pra kristianizmi. për të cilin në atë kohë njerëzit luteshin nëpër kishat e Anglisë.

Kohët e fundit ishte hapur në Ohër një shkollë e vogël serbe, ku më ftuan të merrja pjesë në festën e Shën Savës. Aty u mblodh e gjithë popullsia serbe e Ohrit. Bëmë fotografi së bashku. Duke llogaritur edhe priftin grek, edhe mësuesin e shkollës me gjithë familje, që ishte nga Serbia, si dhe veten time, bëheshin një pesëdhjetë veta gjithsej. Ohri kishte një popullsi shumë të përzier. Më shumë se gjysma ishin myslimanë dhe shumica e tyre shqiptarë. Nga të krishterët pjesën më të madhe e përbënin bullgarët, por kishte edhe shumë vllleh. Këta të fundit grekët i llogaritnin për grekë, por ç'është e vërteta, ata kishin filluar të shfaqnin shenja se kërkonin kombësinë e tyre. Serbët ishin, më diferencë të madhe, grupi më i vogël, aq sa në atë kohë as që përfilleshin fare.

Ohri është konsideruar krahinë shqiptare deri në fillimet e lëvizjes ruso-bullgare. Madje, jo më larg se viti 1860, udhë-

tarë të ndryshëm anglezë i kanë përmendur liqenet e Ohrit dhe të Prespës, si liqene shqiptare.

Gjatë gjithë dimrit të vitit 1903-1904 zien trazira, u bënë arrestime dhe vrasje. Këtu mësova edhe moralin e vrasjes, që në Maqedoni ishte as më shumë e as më pak: «S'ka më mirë krishteri e vret të krishterin është më mirë që krimi të mos sa kur i krishteri vret myslimanin, ai ka kryer një akt të shenjtë e të drejtë. Kur myslimani vret një të krishterë, ai bën një barbarizëm për të cilin u duhet shkruar të gjitha gazetave.»

Grindja ruso-japoneze, që kishte ardhur duke u acaruar gjithnjë e më tepër kohët e fundit, çoi në shpërthimin e pamja e çështjeve ballkanike.

Kur bridhja me kalë për të shpërndarë ndihmat nëpër fshatrat e djegura, nuk e pata aspak të vështirë të mësoja çfarë roli të madh kishte luajtur Rusia në përgatitjen e kryengritjes në Maqedoni. Në çdo fshat dëgjoja të njëjtën histori. Një herë, jo shumë kohë përpara, një zotni i pasur fisnik e bujar kishte vizituar një fshat. Nuk jua merr mendja sa i pasur ishte; ai kishte arritur të paguante një mexhide të bardhë për një kafe; kishte mbledhur parinë e vendit dhe priftin dhe i kishte pyetur nëse dëshironin të kishin edhe ata kishën e tyre në fshat. Dhe kisha ishte ngritur fët e fët në kohën e duhur. Pastaj u kishte ardhur radha shandaneve të argjendtë, veladonëve etj., të cilët u qenë bërë dhuratë po nga ky fisnik — konsulli rus. Turqit kishin vënë dorë mbi thesaret. A donin që ai t'ua zëvendësonte ato thesare? Ndonjëherë konsulli kishte restauruar edhe ndonjë kishë të vjetër, herë tjetër ai kishte derdhur para edhe për hapjen e ndonjë shkolle. Kështu për popullin ai paraqitej kudo si perëndi.

Në gusht u vra konsulli rus i Manastirit, zoti Rostovski, pa ndonjë arsye politike në mes. Rusia kishte menduar se i tërë vendi ishte bërë tanimë i tij dhe se këtu kishte të bënte me një turmë muzhikësh kokulur. Me vete ai mbante gjithnjë një kamxhik të trashë për kuaj, të cilin e përdorte sa herë i shkrepj. Një dëshmitar i ngjarjeve më tregoi një rast kur ai kishte fshikulluar aq kafshërisht një djalë të mitur, vetëm pse fëmija kishte guxuar të kacavarej pas karrocës konsullore, sa ishte dashur ndërhyrja e një xhandari turk. Një ditë tjetër ai kishte fshikulluar një ushtar shqiptar, i cili gjeti rastin, shtiu dhe e vrau Rostovskin mu në rrugën kryesore, ngjitur me konsu-

llatën. Kësaj vrasjeje Rusia i dha ngjyra politike, dhe kërkoi që qeveria turke të kërkonte ndjesë, madje arriti që kjo e fundit të jepte edhe dëmshpërblim. Trupi i konsullit u përcoll me nderime të mëdha për në port. Dhe e gjithë kjo për çfarë, për një konsull rus në Turqi. Kësaj i thonë: ti mund të vjedhësh kalin, kurse unë s'kam leje as të shoh ç'bëhet prapa gardhit. Funerali i Rostovskit që rregulluar aq mirë e bukur, sa fshatarët vendas sllavë e quajtën atë si një martir të kauzës së shenjtë sllave, dhe jo si njeri që e kishte kërkuar vetë belanë.

Megjithatë, Rusia nuk ishte e vetmja fuqi në Manastir. Ai që mbushur me konsuj, më i shquari i të cilëve ishte Krali, konsulli i përgjithshëm austriak, një njeri tepër energjik dhe çallaveraxhi, përfaqësues më se i «denjë» i Austrisë, por që ishte si ferrë nëpër këmbë për konsullin anglez, të cilin e thumbonte sa herë i jepej rasti. Ai arriti t'i bindte misionarët amerikanë që s'merrnin fare erë nga politika evropiane, ndonëse kishin 30 vjet që jetonin në Siujdhesën Ballkanike, se ai dhe jo konsulli anglez do t'u shërbente më mirë interesave të tyre. Këta nxitën me mashtrim qeverinë amerikane që t'i kalonin misionarët dhe shkollat e tyre në protektoratin austriak. Kështu ai dilte gjithnjë në pah duke deklaruar se kishte shumë më tepër fuqi për të ndihmuar në shpërndarjen e ndihmave, duke u përpjekur t'i bënte anglezët që të konsultoheshin me të e jo me përfaqësuesin e vendit të tyre. Kjo gjë më mërziu shumë, prandaj as që i shkova më për vizitë. Në fshatrat kryengritës të zonave malore, dukej qartë se fshatarët fatkeqë ishin shtyrë të ngrinin krye me besimin se edhe këtë herë, si më 1877, Rusia do t'u vinte në ndihmë për t'i shpëtuar. Me kalimin e kohës Rusia sa vinte e po e kuptonte se Japonia ishte një kockë e fortë. Po bëhej gjithnjë e më e qartë se në pranverë nuk do të shpërthenin më kryengritje. Ortodoksët ballkanas janë shumë fanatikë në mbajtjen e kreshmës, për rrjedhojë shpërthimi i një kryengritjeje prapa pashkëve ishte i pamundur. Kështu do të ndodhte këtë vit. Më kumbonin në vesh me një qartësi të veçantë fjalët e polakut, që më kishte dhënë mësimet e para të serbishtes, «Rusia është krimbur kokë e këmbë. Po plasi ndonjë luftë, Rusia do të bëhet — ja kështu do të bëhet!», dhe tërë mllef kishte flakur një shuk letre në koshin e plehrave. Profecia e tij ishte vërtetuar dyfish. Peshkopi bullgar i Ohrit vazhdonte të kishte besim të patundur në pathyeshmërinë e Ruisë. Kur unë nuk pranova të fshihja disa fishekë e gjëra të tjera në dhomën time, të cilën turqit nuk e kontrollonin kurrë, ai m'u kthye si bishë dhe më tha se Anglia

nuk ishte një vend i krishterë, se Rusia e shenjtë do ta zhdukte nga faqja e dheut, se ajo tani kishte marrë gjysmën e Japone tërë Indinë.

Kishim hyrë në mesin e marsit dhe unë isha më se e bindur se nuk do të shpërthente asnjë kryengritje. Ndërsa Forin Ofisi* që, të gjithë ata që merreshin me shpërndarjen e ndihmave, të mbaronin punë dhe të ktheheshin në Angli. Të gjithë u kthyen, përveç meje, që munda të udhëtoja e t'i bija kryq e tërthor Shqipërisë.

* Angl. Foreign Office, Ministria e Punëve të Jashtme.

KREU VII

SHQIPËRIA

«Ku kohë më t'ashpra një racë fisnike nxorën».

BAJRON

Gjatë studimit të çështjes maqedonase kisha mësuar se një nga faktorët më të rëndësishëm në çështjen e Lindjes së Afërme ishte ai shqiptar, dhe se fakti që ai gjithmonë nuk përfillej e lihej pas dore, përbënte një burim të përhershëm vështirësish. Kohët e fundit ishte formuar edhe Komiteti Ballkanik, prandaj vendosa të gjurmoja drejtpërdrejt Shqipërinë, e cila në atë kohë njihej shumë pak, në mënyrë që të merrja të dhëna nga burimi i pandërmjetëm për aspiratat dhe mendimet e shqiptarëve.

Gjatë gjithë punës për shpërndarjen e ndihmave në Maqedoni, në çdo post të besuar ne kishim vënë shqiptarë: përkthyes, shoqërues, rojtarë dhe nëpunës.

Depoja e Shoqërisë Biblike Angleze dhe për Vendet e Huaja ishte në duart e shqiptarëve, të cilët nuk kishin të çmuar për shoqërinë biblike.

Shqipëria po vuante pikën e zezë. Çdo popullsi tjetër që ishte nën sundimin turk kishte shkollat e veta, shkolla që për më tepër subvencionoheshin mjaft nga jashtë. Shkollat bullgare ishin për çudi të pajisura mjaft mirë. Secila nga këto shkolla ishte një qendër aktive e propagandës nacionaliste. Të gjithë mësuesit ishin udhëheqës kryengritës. Të gjithë gëzonin mbrojtjen e konsullatave të ndryshme, të cilat ngulnin këmbë të hapnin shkolla të reja dhe protestonin sa herë që kishin ndërhyrje në këto punë.

Turqit e kuptuan rrezikun e shkollave dhe u përpoqën t'i mbyllnin ato kur ishte tepër vonë. Në fillim ishte shkolla, por pastaj vinte kryengritja, më pas ndërhyrja nga jashtë, dhe kështu shpërbëte edhe një copë tjetër nga territori perandorak turk. Kështu kishte ndodhur me Serbinë, me Greqinë dhe me

Bullgarinë. Dhe turqit morën vendim që kjo gjë të mos përsëritej edhe me Shqipërinë.

Shqipëria ndodhej përballë dy armiqve. Nga njëra anë turku, që i druhej kryengritjes së Shqipërisë, nga ana tjetër Rusia, tashmë e vendosur që Siujdhesa Ballkanike të bëhej sllave dhe ortodokse. Vetëm për grekët, si ortodoksë që ishin, mund të bëhej përjashtim. Ndërsa për të tjerët absolutisht jo.

Qeveria turke e ndaloi botimin e librave shqip dhe mësimin e gjuhës shqipe, duke dhënë dënime nga më të rëndat. U hapën shkolla turke për shqiptarët myslimanë, u bënë lloj-lloj përpjekjesh që fëmijët të rriteshin me besimin se ishin turq. Në Shqipërinë e Jugut, ku të krishterët janë ortodoksë, grekët u inkurajuan që të hapnin shkolla dhe të bënin propagandë greke. Duke vepruar kështu, turqit shpresonin të ndalonin formimin e një lëvizjeje të fortë kombëtare shqiptare. Patriarku grek shkoi deri atje sa të kërcënonte me shkishërim cilindo shqiptar ortodoks që do të përdorte «gjuhën e mallkuar» në kishë ose në shkollë. Në Veri të Shqipërisë, ku të krishterët ishin katolikë, mbrojtjen e tyre Evropa ia kishte besuar Austrisë. Ajo hapi aty shkolla fetare, ku mësimi bëhej në gjuhën shqipe, dhe ku qeveria turke nuk kishte fuqi të ndërhynte. Duke qenë nën mbrojtjen e Austrisë, jezuitët ngritën një shtypshkronjë në Shkodër për shtypjen e librave fetarë në gjuhën shqipe. Por kjo lëvizje, duke qenë ngushtësisht katolike, u kufizua vetëm në Veri. Madje ajo u nis me qëllim që Austria t'i bënte për vete të krishterët e Veriut. Ajo synonte më tepër të përçante të krishterët nga myslimanët dhe t'i dobësonte ata, sesa të forconte ndjenjën kombëtare shqiptare. Rrjedhojat e kësaj loje do t'i ndeshim më vonë.

Asnjë nga këto përpjekje të armiqve të Shqipërisë nuk mundi ta zhdukte instinktin e fortë të shqiptarit për ruajtjen e racës së vet, që i pat dhënë atij forcën e duhur për t'i qëndruar Perandorisë Romake, të mbijetonte pas rënies së Bizantit, të përballonte perandoritë mesjetare kalimtare bullgare e serbe dhe, më në fund, të dilte nga gërmadhat e Perandorisë së fuqishme Osmane, duke ruajtur gjuhën e tij, zakonet dhe energjitë e tij të lashta, si një shkëmb ku valët e pushtuesve janë përplasur e janë thyer.

Kur Traktati i Berlinit kërcënonte t'u merrte shqiptarëve shumë toka nga territori i tyre, ata u ngritën të tërë në këmbë dhe kërkuan t'u njiheshin të drejtat e tyre. Për këtë ka edhe një baladë popullore në gjuhën shqipe, që mallkon Lord Bikënsfil-din, i cili shkoi në Berlin për të shkallmuar Shqipërinë dhe

për t'ia dhënë tokat shqiptare armikut të saj të parnëshirshëm, sllavit. Ky Traktat nuk bëri asgjë për Shqipërinë; ai çoi vetëm në formimin e Lidhjes Shqiptare dhe në një kryengritje shqiptare kombëtare që i la Shqipërisë disa nga tokat që u përmen-dën më lart, në kundërshtim me çka donin Fuqitë e Mëdha. Kjo gjë e shtyu Abdyl Hamidin ta zbuste për pak kohë urdhrin për ndalimin e përdorimit të gjuhës shqipe. Menjëherë u hapën shkollat kombëtare, shtypshkronjat shqiptare filluan të botonin libra e gazeta. Sulltani, i alarmuar nga suksesi i menjëhershëm i lëvizjes kombëtare, e ndaloi përsëri përdorimin e shqipes. Mësuesit u dënuan me burgime të gjata. Kushdo, që kapej me ndonjë gazetë shqiptare në dorë, dënohej me 15 vjet burgim. Priftërinjtë grekë u përfshinë me entuziazëm në këto përndjekje.

Por Shqipëria nuk u shua. Udhëheqës të ndryshëm të lëvizjes shkuan në Bukuresht, në Sofje, në Bruksel, në Londër dhe atje iu përveshën punës. Duke kaluar vështirësi të mëdha dhe duke vënë veten në rrezik, librat e gazetat e shtypura jashtë i fusnin fshehurazi në Shqipëri nëpunësit myslimanë, shumë prej të cilëve si pasojë e kësaj pune, u internuan dhe iu konfiskua e gjithë pasuria.

Por kishte edhe një mjet tjetër me anë të të cilit u fut në Shqipëri literatura shqipe. Gjatë periudhës së shkurtër të kohës, kur u lejua botimi në gjuhën shqipe, u bë një përkthim i Biblës nga Shoqëria Biblike Angleze dhe për Vendet e Huaja. Kjo shoqëri kishte leje nga qeveria turke për të shpërndarë botimet e saj lirshëm. Kur u vu përsëri ligji i ndalimit të shqipes, lindi një pyetje mjaft interesante: A gëzonte kjo shoqëri të drejtën të qarkullonte Biblën në gjuhën shqipe? Qeveria turke nuk kishte as më të voglin kundërshtim ndaj Biblës në vetvete, mjafton që ajo të mos ishte shqip. Vazhdoi një luftë e pandër-prerë për këtë çështje. Drejtori i Degës Biblike në Manastir ishte një shqiptar mjaft i zoti, me kulturë e i shkathët. Duke e kuptuar se me anë të këtyre botimeve mund të bëhej një propagandë e madhe kombëtare, ai nuk kurseu asgjë: zgjodhi dhe stërviti me kujdes librashitës shqiptarë, që kishin për detyrë të mësonin se në cilat krahina kishte nëpunës të rrezikshëm, në cilat ishin simpatizues, dhe ku kishte nacionalistë që me vullnet goftë edhe duke rrezikuar veten, ishin të gatshëm të pranonin e të shpërndanin libra. Në këtë veprim ai pati një sukses të madh.

Grekët sigurisht, ishin kundër kësaj pune. Në fakt, thuhet se një peshkop grek e kishte dënuar përhapjen e «Dhjatës së

Re dhe të veprave të tjera, që janë kundër mësimëve të kishës së shenjtë ortodokse». E megjithatë kjo punë vazhdoi. Unë tës. Kështu m'u dha rasti të takohesha kudo me nacionalistë dhe të shihja me sytë e mi çfarë përmasash kishte marrë ajo lëvizje. Udhëtimi ishte jashtëzakonisht interesant.

U largova nga Manastiri dhe me një karrocë udhëtova përmes tokave të shkatërruara sllave. U habita jashtë mase një tip krejt tjetër njeriu, që ecte i sigurt anës rrugës. Përsëri dallova tiparet e mprehta, trupin thatim e të fortë të shqiptarimit, ecjen e tij të lirshme, po atë tip që kisha takuar te miqtë e mi në Shkodër dhe që ishte krejt ndryshe nga fshatarët bullgarë, me të cilët kisha punuar. E ndjeva veten si në shtëpinë time.

Ndalesën e parë e bëra në Korçë, djepi i lëvizjes kombëtare në Jug. Korçës i kishte dalë emri si qyteti ku ndodhej e vetmja shkollë shqipe në jug të vendit, që qëndronte e hatonte Zonjusha Qiriazi* (tani zonja Dako) një mësuese trimë-të larta. Kjo shkollë ishte gjithmonë plot me nxënës, ndonëse po ta vazhdoje atë, si për prindërit ashtu edhe për nxënësit vetë do të thoshte që të përndiqeshin nga turqit ose të shki-shëroheshin nga prifti grek. Vajzat mësonin të shkruanin e të lexonin në gjuhën shqipe, të cilën ua mësonin pastaj vëlle-zërve të tyre. Shumë prindër më shfaqën dëshirën e tyre të zjarhtë për të pasur edhe një shkollë për djemtë. Mirëpo mësuesi fatkeq i shkollës shqiptare për djem**, i cili u lejua të jepte mësim gjatë periudhës së shkurtër, kur u hoq ligji për ndalimin e shkollave shqip, ishte akoma në burg. E kishin dënuar me 15 vjet burgim. Njerëz të ndryshëm më pyesnin a ishte Anglia në gjendje të hapte një shkollë apo jo! Tani puna qëndronte kështu: fëmija ose duhej të mësonte greqisht, ose të mos mësonte shkrim e këndim fare. Madje mësuesit grekë u thoshin fëmijëve se ishte e kotë që t'i luteshin zotit shqip, sepse Krishti na paskësh qenë grek dhe nuk kuptonte gjuhë tjetër.

* Sevasti Qiriazi (Dako), atdhetare dhe organizatore e arsimit shqip për femrat (1871-1949).

** Naum Dhimitër Naçi (1871-1927), Mësues i Popullit, drejtor i Mësonjëtores shqipe të Korçës.

Kudo ishte e njëjta gjendje. Të dërguar të ndryshëm vinin e më luteshin për shkolla. Madje edhe priftërinjtë ortodoksë shqiptarë merrnin guximin të më thoshin se ata kërkonin të kishin një kishë të pavarur. Rumania, Serbia, Greqia, madje edhe Mali i Zi, secila ishte e lirë të zgjidhte priftërinjtë e saj dhe të lutej e të kryente shërbesat fetare në gjuhën e vet amëtare. Veçanërisht, në Leskovik dhe në Përmet, njerëzit prisnin me padurim shkollat dhe kishën shqiptare.

Jo vetëm midis të krishterëve, por edhe ndër myslimanët shquhej një ndjenjë e theksuar kombëtare. Një pjesë e madhe e myslimanëve të Jugut nuk ishin aspak myslimanë-ortodoksë, por anëtarë të njërit nga sektet e dervishëve — të bektashinjve, dhe si të tillë shikoheshin me dyshim nga Stambolli. Midis të krishterëve dhe bektashinjve nuk dukej të kishte ndonjë fërkim. Xhamitë nuk ishin edhe aq të mbushura. Kajmekami i Leskovikut më siguroi se shumë nga nëpunësit myslimanë ishin bektashinj dhe në xhami shkonin vetëm sa për formë, se ndryshe nuk mund të qëndronin në postin që kishin. Ai nuk e kishte fare të qartë si ishte puna e kristianizmit dhe më kërkoi t'i shpjegoja përse grekët dhe bullgarët, që të dyja palët të krishtera, nuk pushonin së vrari njëri-tjetrit. Ai më tha: «Evropës i thonë se janë kundër sundimit mysliman, por me siguri ata do të masakrojnë njëri-tjetrit, po të ikim ne. E ç'të mira kanë ata nga ky kristianizëm?» Unë iu përgjigja se edhe unë nuk e merrja vesh këtë punë.

Kryengritja maqedonase pati jehonë të madhe në Shqipëri. Kudo njerëzit mendonin se puna e shpërndarjes së ndihmave ishte propagandë nga ana e qeverisë angleze. Fuqitë e tjera shpërndanin të holla për qëllimet e tyre në territorin turk. Po Britania e Madhe përse të mos e bënte edhe ajo këtë punë? Ky ishte një përfundim i natyrshëm. Për më tepër, vetë maqedonasit besonin se ndihma që merrnin u vinte nga Fuqia e Madhe — Anglia.

Vetë emri Komitet Ballkanik ishte çorientues. Në Lindjen e Afërme çdo komitet quhet komitet kryengritës e përbëhet nga komitë të armatosur. Shumë herë i kam siguruar popujt e Ballkanit të të gjitha racave se Komiteti Ballkanik nuk merret me kontrabandë armësh, por ata kurrë nuk e kanë besuar këtë gjë.

Kudo që shkoja, shqiptarët më kërkonin që të sigurohej lord Lensdouni, atëherë ministër i punëve të jashtme, se po t'i furnizonte me aq armë sa kishte furnizuar bullgarët, ata do të bënin një kryengritje të suksesshme.

Përsa u përket dhjatave në gjuhën shqipe, ato i blenin si myslimanët, ashtu edhe të krishterët.

Berati kishte një konsull grek dhe një kajmekam turk. Policia na ndali në hyrje të qytetit dhe na konfiskoi të gjitha librat shqip që kishim me vete. Ndërsa për librat turqisht dhe greqisht nuk pati pengesë. Gjuha e jo përmbajtja e librit ishin të ndaluara këtu. Në qytet kishte shumë patriotë. Kudo ishte marrë vesh ardhja jonë dhe njerëzit nxitonin t'i tregonin «zonjës angleze» shpresat dhe rreziqet e Shqipërisë. Nuk mbaj mend as edhe një rast të vetëm, që të vinte dikush e të më thoshte se Shqipëria donte të bashkohej me Greqinë, por gjithnjë dëgjohej të thuhej: «Na jepni shkollat tona. Na shpëtoni nga prifti grek». Në Elbasan gjetëm një vandak me libra, që i kishin dërguar nga Manastiri për ne, si parapërgatitje për çka do të ngjiste në Berat.

Këtu ndodhej një mytesarif plak shqiptar shumë i lezetshëm, i cili bëri ç'ishte e mundur që të ma bënte vizitën të këndshme. Ai m'u lut që të dërgoja sa më shumë vizitorë nga Anglia. Kishte qenë guvernator i Tripolit (që tani është marrë nga Italia) dhe, siç më tregoi vetë, kur qe kthyer në Shqipëri pas aq shumë vjetësh shërbimi jashtë shtetit, ishte tmerruar kur e pati parë vendin e tij më të keqtrajtuar dhe në gjendje më të mjeruar se të gjitha krahinat e Perandorisë Osmane, ku kishte qenë. Për çështjen e shkollave ai nuk të falte dhe e shpallte hapur qëllimin e tij: në shkolla të mësohej gjuha shqipe. Sa për librat që kishim me vete, mund të shisnim sa të dëshironim, sa më shumë aq më mirë. Djemuria e shkollës myslimane vinte turma-turma për t'i blerë. Këta libra ne ua shitëm edhe disa shqiptarëve me uniformën e oficerëve turq.

Këtu njihej edhe revista «Albania», që botohej në Londër nga Faik beu*. Në Elbasan po bëheshin përpjekjet përfundimtare për t'u shkëputur nga kisha greke. Një prift shqiptar, që kishte shkuar për vizitë në Romë, kishte kërkuar leje për hapjen e një kisha unite në Elbasan. Ai ishte i biri i një të pasuri dhe, pasi mori pëlqimin e Romës, u kthye me mendje që të ndërtonte një kishë me paratë e veta, madje bleu edhe një copë tokë. Mirëpo leja për të ndërtuar një kishë duhej marrë së pari nga qeveria turke, e ai mendonte se do ta merrte për së shpejti. Qeveria turke, duke qenë e ndërgjegjshme se kjo nuk ishte gjë tjetër veçse një veprim i lëvizjes kombëtare, nuk i dha kurrë leje, megjithëse çka është interesante, këtë çështje e mbajti të hapur për një kohë të gjatë.

* Faik Konica (1876-1942).

Në malet e Shpatit, në afërsi të Elbasanit, banojnë njerëz që në shumë drejtime u ngjajnë malësorëve të Veriut dhe që kanë ruajtur njëfarë gjysmë pavarësie. Të krishterët i klasifikonin ata si kriptokristianë. Mirëpo në ato malësi, që vizitova, nuk pashë as kisha e as xhami. Për të qenë në rregull me çështjen e fesë, çdo njeri mbante dy emra. Kur e pyeste një mysliman, ai përgjigjej se quhej Sulejman, kur e pyeste një i krishterë, ai ishte Kostandin. Kur u kërkohet të paguanin tak-sën, të cilën të krishterët e jepnin në vend të shërbimit ushtarak, banorët e këtyre zonave nuk pranonin ta jepnin, duke thënë se ishin myslimanë dhe se nuk kishin kisha. Nga ana tjetër, kur thirreshin për shërbimin ushtarak, ata kundërshtonin duke thënë se ishin të krishterë. Kështu që në të shumtën e rasteve turqit nuk u binin në qafë. Mirëpo kishte edhe atdhetarë të cilët, kur u hodh propozimi për të krijuar një kishë unite, deklaruan se do të bashkoheshin me atë të Romës. Kur u përhap ky lajm, fuqitë ortodokse u shqetësuan aq shumë, sa menjëherë dërguan në vend një zëvendëskonsull rus. Megjithatë, banorët e Shpatit, të cilët nuk ishin fare të qartë për çështjet e doktrinafe fetare, e kishin shumë të qartë se nuk dëshironin të kishin të bënë me asgjë ruse, kësisoj, rusi, të cilin e kishin udhëzuar t'i blinte ata me flori po të ishte nevoja, u detyrua të ikte me nxitim.

Kjo krahinë vështirë se ishte vizituar ndonjëherë nga të huajt, kështu që vizita ime i kënaqi pa masë.

Kalova prej këtej në Peqin, Kavajë, Durrës, Tiranë, Krujë — qyteti i Skënderbeut dhe sot qendër bektashizmi, e arrita më në fund në Shkodër, ku më priti zoti Suma, që rridhte nga një fis malësorësh. Më përpara ai kishte punuar si përkthyes-shoqërues i konsullatës, ndërsa tani ishte emëruar zëvendëskonsull. Ai shprehu kënaqësinë për udhëtimin tim dhe më tha se ishte i gatshëm të më shëtiste nëpër malësi, kur të dëshiroja unë. Më shpjegoi diçka në lidhje me vizitën time të parë; duke qenë se zoti Prendergast kishte ardhur në këtë vend për herë të parë, ishte këshilluar me konsullatën austriake nëse ishte e mundur që unë të udhëtoja në brendësi të vendit. Austriakët, të cilët nuk donin që të huajt të hynin në malësi, ndonëse vetë dërgonin një numër të madh turistësh në ato anë, i kishin bërë një përshkrim aq shqetësues për rreziqet që paraqiste ai udhëtim, sa kishte qenë detyruar të më thoshte se udhëtimi ishte i pamundur. Ndërsa tani zoti Suma e rregulloi aty për aty që unë të vizitoja Mirditën.

Abati i Mirditës, Preng Doçi*, në të ri kishte ikur nga Shqipëria pse kishte marrë pjesë në Lidhjen Shqiptare dhe kishte nxitur qëndresën kundër sundimit turk dhe vendimeve të Traktatit të Berlinit. I kishte kaluar vitet e mërgimit në Trakland e Indi si prift. Gjatë asaj kohe kishte mësuar anglisht dhe kishte lexuar shumë. Ai kishte shpikur një alfabet për gjuhën shqipe, i cili nuk përmbante thekse dhe shkronja të trilluara e në vend të tyre përmbante gërma të zakonshme latine. Ai i kishte bindur autoritetet austriake që ta përdornin këtë sistem në shkollat e tyre dhe ishte tepër entuziast për librat që po përgatiste. Me shumë peripeci kishte mundur të hapte edhe një shkollë të vogël pranë kishës së tij në malësi.

Fliste me mençuri. Nga lartësitë e atij vendi qëndronim e vështronim Shqipërinë: vargmale e njëri pas tjetrit, si valët e gurta të një deti të madh, që zgjatoheshin e rrokulliseshin drejt një horizonti mrekullisht të kaltër, dhe humbisnin më në fund në qiell tutje, në një largësi të kuqërreme të zbehtë. Dhe ai i shtrinte duart drejt atij horizonti plot krenari e entuziazëm. Ai thoshte se të punosh kundër turkut tani është gabim. Turku nuk është më armiku më i egër i Shqipërisë. Vendi vërtet kishte vuajtur tmerrësisht nga turku, por Shqipëria nuk vdiq. Përkundrazi. Ndërsa tani ishte një armik tjetër, madje shumë më i egër se turku, një armik që po forcohej dita-ditës. Ky armik ishte sllavi. Rusia, me kishën e saj fanatike dhe me bandat e saj të egra serbe dhe bullgare, ishte gati ta shkretonte Shqipërinë dhe t'i zhdukte njëherësh katolikë e myslimanë bashkë.

Pastaj ai zgjati dorën në drejtim të Pejës.

«Tutje, matanë, — më tha, — shtrihet vendi që serbët e quajnë Serbia e Vjetër. Por ai është një Shqipëri akoma më e vjetër. Tani ai vend banohet nga shqiptarë, shumë prej të cilëve janë viktimat ose fëmijët e viktimave të Traktatit të Berlinit. Ata janë shqiptarë që kanë jetuar brez pas brezi në ato troje, të cilat Traktati ua dha serbëve dhe malazezve, që i përzunë e i shpërngulën me dhunë shqiptarët për të vdekur urie në dhe të huaj. Me qindra mbetën maleve. Ja, për shembull, shihe Ulqinin, një qytet tërësisht shqiptar. Ai u kërcënua nga luftanijet e Fuqive të Mëdha, të cilat na e shkëputën me dhunë. Pa thua, e si mund t'i bënim ballë tërë Evropës? Serbët dhe malazezët janë sjellë sa s'bëhet më kafshërisht me popullin

* Poet klerik (1848-1917), themelues i Shoqërisë «Bashkimi» në Shkodër, por që luajti rol negativ në ngjarjet e kryengritjeve të mëdha në vitet 1910-1912.

tonë, ndërsa Gledstouni i madh rrinte e bënte sehir. Tashti bërtasin se janë shqiptarët e Kosovës që i keqtrajtojnë sllavët. E ç'mund të prisni? Shqiptarët e dinë mirë se edhe sikur dhjetë të serbë të jetojnë në një copë vend, Rusia do të stërbetohet se ajo është plotësisht krahinë serbe. Dhe ata janë betuar ta shpaguajnë humbjen e Ulqinit.»

Në atë kohë pata premtuar se do të vija të gjitha fuqitë e mia për ta bërë Shqipërinë të njohur në Angli dhe se do të punoja për lirinë e saj. Ai, nga ana e tij, u tregua i gatshëm të më shoqëronte në Guci, në Gjakovë e në ndonjë krahinë tjetër që dëshiroja, dhe do të bënte ç'ishte e mundur për të më ndihmuar në udhëtimet e mia. Ndërkohë, pushimet e mia kishin mbaruar dhe më kishin ardhur njoftime që të kthehesha urgjentisht në Angli.

Kështu u ndava nga ato male të egra, duke lundruar sërish nëpër liqenin e Shkodrës drejt Rijekës.

KREU VIII

VRASJA DEL NË SHESH

Në Cetinjë arrita me një kalë të ushtrisë turke, me dy hejbe të ngarkuara me disa kobure stralli dhe me një tufë pendësh të bukura struci, që m'i kishte bërë dhuratë mytesarifi i Elbasanit, si dhe me ca rrecka të tjera.

Cetinja u shqetësua shumë kur mori vesh se vija drejt nga Shqipëria. Malazeztë u thoshin të gjithë turistëve anglezë, që donin të vizitonin Shkodrën, se jashtë qytetit të priste vdekja, se çdo ditë bëheshin vrasje në mes të pazarit e përralla të tjera absurde si këto, që në fakt kishin për qëllim të njollosnin shqiptarët. Qëndrova në dhomë dhe si mbarova së arnuari mëngët, po shkurtoja ca fustanin tim më të mirë, sepse më ishte ngrënë pak në fund, kur erdhi Vuko Vuletiçi e më tha se poshtë një mareshal i Oborrit po priste e kërkonte të fliste me mua.

Zbrita poshtë dhe pashë se aty më priste zotëria, veshur e ngjeshur mirë e mirë. Atë ditë ishte festë.

U përshëndetëm.

— Lartmadhëria e tij mbretërore, princi, dëshiron t'ju takojë e të bisedojë me ju, — tha ai i ngrefosur. — Ai dëshiron të dijë se cilën orë do ta kishit të përshtatshme për të ardhur në pallat.

Ishte hera e parë që kisha tërhequr vëmendjen e princit. Ishte diçka argëtuese dhe shumë e kënaqur iu përgjigja:

— Jam gati të vij që tani, në qoftë se dëshiron lartmadhëria e tij!

Mareshali i Oborrit më hodhi një shikim të dyshimtë dhe ngurroi për një çast. Por unë vazhdova e vendosur:

— Ja, sa të laj pak duart, dhe jam gati; rroba të tjera përveç këtyre nuk kam.

Të vetmet rroba të tjera që kisha, ishin në lavanderi, dhe ato që kisha veshur i kisha arnuar vetë, me aq sa më lejonin rrethanat. Mareshali i Oborrit u përkul dhe doli. Nuk vonoi shu-

më dhe ai u kthye me njoftimin se lartmadhëria e tij mbretërore ishte gati të më priste që në atë moment, «i veshur me uniformë ushtarake».

U nisa e bindur pas tij dhe arritëm në pallat. Të gjithë ishin veshur si për ditë feste: malazeztë nuk linin t'u shpëtonte asnjë rast për t'u ngrëfosur si gjeli. E gjithë situata më pëlqeu pa masë. Mareshali kishte veshur më të mirën bluzë të bardhë që kishte dhe mbi të kishte hedhur një jelek të punuar me ar. Kishte mbështjellë rreth belit një brez mëndafshi dhe dukej shik. Aty më priti edhe një funksionar tjetër, po ashtu i veshur me rroba të shkëlqyera; më vunë në mes dhe më shoqëruan. Sapo ngjita shkallët, u ndodha përballë një pasqyre të madhe, ku për herë të parë pas katër muajve e pashë veten ashtu siç më shihnin të tjerët. Midis këtyre dy alamet binave, që ndrisnin plot hijeshi, qëndronte një qenie e imët, e thatë, e sfilitur, me lëkurë ngjyrë bronzi të rreshkur nga dielli, e veshur me rroba që kurrë nuk kishin qenë ndonjëherë kushedi se çfarë, ndonëse vite më parë edhe ato kishin qenë të reja. Gati sa s'ia plasa të qeshurit, kur pashë knjazin veshur me uniformë, me atë gjoksin e fryrë mbuluar me disa radhë medaljesh dhe urdhrash. Ai po më priste. Ka një paragjykim në popull, që ushqehet dhe nxitet mjaft prej gazetarëve, të cilët paguhën nga sallonet e modave, se në do që të ecësh e të kesh sukses në jetë, është e domosdoshme të shpenzosh shuma të pallogaritshme për veshjen. Por në fakt, në qoftë se dikush vërtet do të nxjerrë diçka nga ju, ai nuk vë re si dukesh nga pamja e jashtme. Nuk ka kostum që mund të të vijë në ndihmë, kur je bosh dhe s'ke ç'të thuash.

Knjazi më futi në një dhomë tjetër, më përshëndeti me shumë mirësjellje, m'u lut të ulesha duke më bërë shenjë me dorë, pastaj më zbrazi një lumë me pyetje për udhëtimin tim në Pejë vitin e kaluar.

— A e dini zonjushë, — më tha, — se ajo që keni bërë ju ka qenë tepër e rrezikshme?

— Madhëri, — iu përgjigja — ishin malazeztë tuaj ata që më shtynë ta bëja atë udhëtim.

Ai nuk e zgjati më, por u qa se tani për tani as që bëhej fjalë që ai të ndërmerre një udhëtim të tillë. E mbi të gjitha, ai kishte dëshirë të shikonte Patriarkinë e Pejës dhe kishën e Deçanit, si dhe reliktet e Sveti Krajlit. I kishin thënë se unë kisha shtënë në dorë disa fotografi të këtyre vendeve. Në qoftë se ishte vërtet kështu, a mund t'i jepja ndonjë kopje?

I premtova se do t'i dërgoja disa kopje nga Londra. Më falenderoi dhe për një moment ra heshtje. Nuk isha e sigurt nëse

ky ishte qëllimi i vërtetë i kësaj ftese për në pallat dhe a kishte ardhur koha për t'u larguar, por Nikita m'i nguli sytë une ashtu si papritur më tha:

— Më duket se ju zonjushë, e njihni dhëndrin tim, kral Petrin e Serbisë.

E shkreta unë, tani duhej kujdes, çështja ishte delikate.

— Nuk e kam pasur atë nder, madhëri, — iu përgjigja. Po pyesja veten se deri ku duhej të shkoja. Tani duhej të kisha kujdes. — Unë isha në Serbi, madhëri, — vazhdova me guxim, — gjatë periudhës kur ishte gjallë i ndjeri kral Aleksandri.

Nikita më vështronte mua, unë soditja Nikitën. Pastaj ai lëshoi një psherëtimë të thellë, kumbuese, që përputhej mjaft mirë me përmasat e kraharorit të tij të madh.

— Ngjarje e shëmtuar, apo jo zonjushë? — më pyeti dhe psherëtiu përsëri.

O tani o kurrë, mendova, është koha për të lëshuar balonën.

I hodha një vështrim të dëshpëruar Nikitës, u përpoqa të lëshoja edhe unë një psherëtimë sa munda të thellë, dhe i thashë nergut:

— Shumë e shëmtuar, madhëri, por ndoshta e domosdoshme!

Kisha qëlluar në shenjë. Nikita lëshoi duart me forcë mbi qillotat e tij bojë qielli dhe thirri me të madhe, i rrëmbyer në kulm:

— O zot i madh, keni të drejtë, keni një mijë herë të drejtë, zonjushë! Ishte e domosdoshme, por ja që vetëm ju keni mundur ta kuptoni. Ju lutem, kthehuni në Angli dhe shpjegojani këtë gjë Forin Ofisit tuaj, politikanëve tuaj, diplomatëve tuaj.

Ai shpërtheu në një entuziazëm të pakufishëm dhe fjalët i rridhnin si lumë nga goja. Tani, më siguroi, çdo gjë do të shkonte vaj. Serbia shpëtoi. Madje, po të shkoja në Beograd, tani mua do të më krijoheshin të gjitha lehtësitë.

Mbeta shtang nga sukcesi që korra. Për çudinë time të madhe këtu po shihja një sovran në fron, që ishte zbërthyer e më kishte hapur barkun plotësisht. Pa e hedhur mirë grepin, salmoni e gëlltiti të tërë brenda, dhe çfarë salmoni se! Nikita, i mbushur me shpresa se pas kësaj interviste do të vinte rivedosja e marrëdhënieve diplomatike midis Anglisë dhe Serbisë, më dhuroi një fotografi të bukur të tij me autograf; thirri marshalin e Oborrit dhe e porositi që atë fotografi të ma çonte në hotel. Me sa dukej, ishte mungesë etikete që këtë barrë ta çoja deri në hotel. Audienca mbaroi.

Pavarësisht se çfarë u kishte thënë gazetarëve, tani ishte më se e qartë se plakun e kishte miratuar mënyrën e vdekjes së të fundmit të Obrenoviçëve dhe se vetë ai kishte punuar «në prapaskenë».

Më vonë pata edhe shumë takime të tjera me Nikitën dhe, megjithëse i ngrita kurthe, kurrë nuk munda ta zë gafil si herën e parë. Disa njerëz mendojnë se politika e jashtme mund të bëhet me sukses nga kryeministra dhe ministra të Jashtëm, që flasin vetëm anglisht. Ndërsa unë them se informatat, për të cilat fola më lart, nuk do të mund të ishin nxjerrë kurrë me anën e një përkthyesi, sepse përkthyesi i jep palës tjetër kohë për t'u menduar.

Pas një jave u ktheva në Londër. Nuk ishte mbushur akoma viti që nga vdekja e Aleksandrit. Nikita e kishte shprehur qartë se atë ngjarje e konsideronte një hap shumë të rëndësishëm në historinë e Serbisë dhe kërkonte që unë të shkoja në Beograd. Por mua kjo gjendje më dukej shumë e errët. E dija se serbët nuk e shihnin me sy të mirë Malin e Zi, por ndoshta jo Nikita.

Sipas pohimeve që bënë ata vetë, malazeztë më kishin rrezikuar mua për qëllimet e tyre, duke më dërguar në Pejë. Në të vërtetë, në atë kohë më dukej se jeta ime nuk kishte ndonjë vlerë të madhe dhe se nuk isha aq trimëreshë sa më bënin, por sidoqoftë, ata nuk kishin përse të më fusnin në këtë ndërmarrje. Edhe sikur të shkoja në Beograd, kësaj radhe unë do ta bëja për një qëllim të panjohur dhe nuk do të shkoja si emisare e Nikitës.

Ardhja në Londër e princ Albert Gjikes përbën një episod qesharak. Ai ishte rumun, por shtypit vendës i deklaroi se ishte pretendues i fronit shqiptar. Pati disa gazetarë, bile edhe në zë, që e morën seriozisht. Mirëpo fatkeqësisht për të, ardhja e tij në Londër përkoi me kthimin tim nga Shqipëria. Unë isha në gjendje të pohoja jo vetëm se kombi shqiptar nuk e pranonte një gjë të tillë, por as nuk ia kishin dëgjuar ndonjëherë emrin këtij njeriu. Nga një takim shumë zbavitës që pata me të, arrita të kuptoja se ai nuk dinte asnjë fjalë nga gjuha e vendit që kishte adoptuar. Ai kishte plane madhështore, në të cilat parashikohej si kryeqytet Stambolli. «E përse jo?» pyeti ai. Kjo gjë do të shuante grindjet e Fuqive të Mëdha për këtë qytet dhe do të vendoste paqen. Mustaqet e tij të përdredhura, parfumet që hidhte, kapadaillëku i pashoq që tregonte, mburrjet sikur ai qenkej një «madhëri mendjendritur», e bënë atë një mall tregu të hatashëm. Por as rroga fantastike që më ofroi,

për t'u bërë zonjë nderi ose zonjë e ceremonive (nuk më kujtohet cilin nga këto dy funksione) në Oborrin e Shqipërisë, nuk më bindi që ta përkrahja çështjen e tij, e cila u zhduk si perde e hollë tymi, sapo gazetarët e zhvendosën vëmendjen në një lajm të ri sensacional.

Megjithatë për njëfarë kohe Albert Gjika u soll vërdallë në prapaskenat e Ballkanit. Vetëm në Shqipëri ai nuk arriti të bëhej i njohur.